

Thirrje për shprehje të interesit: Ekspert/e për angazhim të diasporës

1. Rreth Organizatës GERMIN

Germin është një organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet virtuale për të lidhur dhe angazhuar Diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre. Germin filloi në 2011 si një grup joformal që përpqej të gjente rrugën për t'u lidhur me atdheun dhe u themelua zyrtarisht në 2014. Germin drejtohet dhe mbështetet nga një grup profesionistësh të Diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informacionit, teknologjisë, ligjit, arsimit, sigurisë dhe diplomacisë. Ne kemi një rrjet të gjerë profesionistësh dhe bashkëpunëtorësh me kohë të pjeshme, aktualisht banojnë në 24 vende, përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut.

2. Rreth projektit “Angazhimi i Diasporës për Avancimin e Politikbërjes në Kosovë”

Germin është duke implementuar projektin “Angazhimi i Diasporës për Avancimin e Politikbërjes në Kosovë” me mbështetje të Smart Ballkans. Qëllimi parësor i këtij projekti është përmirësimi i proceseve politikë-bërëse në Kosovë, përmes optimizimit të kontributeve të diasporës. Germin synon ta arrijë këtë qëllim përmes dy objektivave kryesore: A) Mbështetja për avancimin e zërit të diasporës - Ky objektivi përfshinë lehtësimin e angazhimit të drejtpërdrejtë të profesionistëve të diasporës në proceset e politikbërjes. Projekti do të shfrytëzojë teknologjitë e reja dhe kanalet virtuale të komunikimit për të siguruar që perspektivat dhe ekspertiza e diasporës të integrohen në mënyrë efektive në iniciativat politikëbërëse. Duke avokuar për përfshirjen e zërit të diasporës, projekti synon të kapërcejë hendekun midis qeverisë dhe komunitetit të diasporës, duke krijuar një proces më gjithëpërfshirës dhe përfaqësues politikbërjeje. B) Përdorimi i aftësive dhe njohurive për zhvillimin e politikave - Ky objektivi fokusohet në përdorimin e aftësive dhe njohurive të profesionistëve të diasporës për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme dhe efektivitetin e zhvillimit të politikave dhe legjisllacionit. Projekti synon të përmirësojë proceset gjithëpërfshirëse për zhvillimin e politikave duke ofruar hulumtime, dizajnim të politikave dhe ekspertizë për rrjetëzim për Kuvendin e Kosovës. Duke shfrytëzuar kapitalin njerëzor të komunitetit të diasporës, projekti synon të përmirësojë kapacitetin e institucioneve politikëbërëse në Kosovë për të krijuar dhe zbatuar politika efektive në funksion të qytetarëve.

3. Objektivat e thirrjes

Eksperti/ja për angazhimin e diasporës do të ofrojë njohuri dhe udhëzime të vlefshme gjatë gjithë fazave të zbatimit të projektit, duke siguruar që projekti të angazhojë në mënyrë efektive komunitetin e diasporës dhe të adresojë nevojat dhe interesat e tyre. Eksperti/ja do të ndihmoj, ndërmjetësoj, mobilizoj komunitetet dhe individët nga diaspora për t'u bërë pjesë e proceseve avokuese për avancimin e politikë-bërjes në raport me diasporën në Kosovë. Ekspertiza dhe angazhimi i ekspertit/ës duhet të sigurojnë që projekti të jetë gjithëpërfshirës dhe përfaqësues i diversitetit brenda komuniteteve të diasporës.

4. Kërkesat specifike për ekspertin/ën e angazhuar:

1. Organizimi i takimeve koordinuese me komunitetet dhe individët nga diaspora për avokim dhe angazhim në proceset e politikëbërjes në Kosovë
2. Identifikimi i barrierave dhe nevojave dhe ofrimi i alternativave për angazhim dhe e diasporës në Kosovë
3. Këshillimi i komuniteteve të diasporës dhe individëve mbi praktikatat më të mira për angazhimin e diasporës në proceset e politikëbërjes në vendet amë
4. Ndërmjetësimi (fasilitimi) i takimeve mes komuniteteve të diasporës dhe hisedarëve relevant në Kosovë

5. Përgjegjësitë e Ekspertit/ës

1. Analizimi i diskutimeve nga takimet mes diasporës dhe hisedarëve vendorë; përpilimi i raporteve analitike mbi diskutimet;
2. Ofrimi i rekomandimeve, sugjerimeve dhe propozimeve për diasporën dhe organizatën GERMIN rreth realizimit të objektivave të këtij projekti; përpilimi i dokumenteve të shkurtra të politikave rreth temave të diskutuara (policy memos, policy briefs, white papers, etc.);
3. Identifikimi i anëtarëve të diasporës që do të angazhohen në grupet këshilluese brenda projektit; identifikimi i organizatave të diasporës me relevancë për projektin.
4. Identifikimi i barrierave të mundshme si dhe mundësi për implementimin e strategjisë shtetërore të diasporës;
5. Rritja e vetëdijes tek hisedarët lokal (Kuvendi, Ministria, orgnizatrat relevante) mbi rëndësinë e përfshirjes së diasporës.

6. Kriteret të cilat duhet të plotësohen për angazhim në cilësinë e Ekspertit/ës

1. Të kenë përvojë në hulumtim, monitorim dhe dizajnim/hartim të politikave dhe përfshirjes së komunitetit
2. Të ketë njohuri të avancuara mbi diasporën, migrimin dhe fushat relevante
3. Të ketë shkathësi të larta të shkrimit akademik në gjuhën shqipe dhe angleze
4. Të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune relevante
5. Të jetë bashkëpunues/e dhe i/e shkathtë në punë ekipore
6. Të jetë i/e gatshme të mbaj takime konsultuese me ekipin për një periudhë më të gjatë kohore

7. Dokumentet e kërkuara dhe procedura e aplikimit

1. Oferta financiare në përputhje me ditët (8) totale të punës të kërkuara;
2. Të paktën dy referenca të punëdhënësve të mëparshëm;
3. Dëshmi të punës relevante (dokumente, raporte, propozime të politikave, etj.);
4. CV e cila dëshmon angazhimin në fusha/detyra të ngjashme.
5. Dokumentet e kërkuara në pikën shtatë të këtij ToR të dërgohen në adresën elektronike apply@germin.org - subject: Shprehje të interesit: Ekspert/e për angazhim të diasporës

6. Data e fundit për aplikim 10 nëntor 2023, ora 23:59 (CET)

Kjo thirrje është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e kësaj thirrje është përgjegjësi vetëm e GERMIN si zbatues i projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)